



Data: 29/07/2019

Ref.: 1865/190

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L0031, datë 25.05.2016), nenit 7 dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ Nr.15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2019, Nr. 08/2019 dhe Nr. 13/2019 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 73-të dhe 74-të, të mbajtur më 19.06.2019 dhe 15.07.2019, mori:

V E N D I M

- I. Nuk riakreditohet Kolegji "Iliria" në nivel institucional.
- II. Riakreditohen programet e studimit të Kolegjit Iliria për periudhën tri vjeçare 1 tetor 2019 – 30 shtator 2022:
 - Juridik, LLB 240 ECTS, maksimumi 130 studentë për vit akademik.
 - Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi, MA 120 ECTS, maksimumi 75 studentë për vit akademik.
- III. Ndalohet regjistrimi i studentëve të rinj për të gjitha programet e studimit me akreditim valid të Kolegjit Iliria për vitin akademik 2019 – 2020 deri në periudhën e riakreditimit të dytë institucional.
- IV. Obligohet Kolegji Iliria që deri me datë 1 tetor 2019 të dorëzoj në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna në raportin final të ekspertëve ndërkombëtar të akreditimit mbi akreditimin e programeve të përmendura më lart.
- V. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m i

I. Kolegji Iliria ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) për riakreditim institucional dhe të programeve të studimit të cekura në dispozitiv të këtij vendimi. AKA ka organizuar vizitën në Kolegjin Iliria më datë 17.05.2019 me qëllim të vlerësimit në nivelin institucional dhe të

programeve të studimit me ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit më këtë përbërje: Dr. Anca Prišacariu, Prof. Dr. Johannes Falterbaum, Prof. Dr. Mirjana Pejić Bach dhe znj. Ketj Tsojniashvili.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e mbajtur më 19.06.2019 dhe 15.07.2019 ka shqyrtuar aplikacionin e Kolegjit Iliria dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitës, dhe në rekomandimet përfundimtar të dhëna në raportin final të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Në lidhje me riakreditimin institucional, raporti i ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit, konstaton se Kolegji Iliria përmbush pjesërisht kapitujt e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit. Nga gjithsejtë njëmbëdhjetë (11) kapitujt e standardeve të parapara në Manualin e Akreditimit, ekspertët kanë konstatuar se Kolegji Iliria i plotëson substancialisht tre (3) (Planifikimi dhe menaxhimi i buxhetit; Burimet dhe hapësirat mësimore; Bashkëpunimi institucional), pjesërisht katër (4) (Misioni publik dhe objektivat institucionale; Mësimdhënia dhe të nxënit; Hulumtimi; Administrimi i studentëve dhe shërbimet mbështetëse), ndërsa nuk plotëson katër (4) kapitujt e mbetur (Planifikimi strategjik, qeverisja dhe administrimi; Integriteti akademik, përgjegjësia dhe llogaridhënia publike; Menaxhimi i Cilësisë; Stafi, proceset e punësimit dhe zhvillimi profesional).

Sa i përket deklaratës së misionit dhe objektivave institucionale, ekspertët në mes tjerash, kanë gjetur se deklarata e misionit mësimdhënien dhe hulumtimin, mirëpo nuk është përfshirë shërbimi për komunitetin, që po ashtu është një prej tri shtyllave të rëndësishme për një institucion të arsimit të lartë. Po ashtu, deklarata aktuale e misionit është shumë e përgjithshme dhe ekipi i ekspertëve beson se misioni duhet të prezantojë atë që a bënë Kolegjin Iliria ndryshe nga institucionet tjera. Ekipi i ekspertëve konsideron se formulimi i deklaratës së misionit nuk është mjaft i qartë dhe specifik për të orientuar në mënyrë efektive planifikimin strategjik, vendimmarrjen dhe funksionet e institucionit. Deklarata e misionit është miratuar në vitin 2001. Megjithatë menaxhmenti i institucionit potencoi se misioni është rishikuar në ndërkohë, gjatë takimit të zhvilluar me panelin nuk ishte e qartë se cilat elemente të misionit janë rishikuar dhe kur, si dhe nuk kishte dëshmi të procesit të konsultimit lidhur me rishikimin e misionit. Sipas ekspertëve ndërkombëtar të akreditimit deklarata zyrtare e misionit e Kolegjit nuk gjendej në uebfaqen e institucionit.

Sa i përket kapitullit të standardeve "Planifikimi strategjik, qeverisja dhe administrimi", ekipi i ekspertëve ka konstatuar se kjo fushë nuk përmbushë standardet e akreditimit. Planin strategjik të institucionit është zhvilluar për periudhën 2018-2022 nga një Komision që në përbërje kishte 2 përfaqësues të tregut të punës, 1 student dhe 1 të diplomuar, mirëpo ekspertët nuk kanë gjetur dëshmi të konsultimeve jashtë përbërjes së këtij komisioni. Sipas ekspertëve planin strategjik nuk alokon burime (materiale, njerëzore e financiare) dhe nuk ndanë përgjegjësi për secilën prej objektivave. Në këto rrethana ekipi i ekspertëve konstaton se nuk është e qartë se si institucioni e përdorë planin strategjik për të përkrahur vendimmarrjen për ndarjen e resurseve si dhe kush janë përgjegjësit për secilën objektivë. Gjatë vizitës ekipi i ekspertëve ka vërejtur se lidhshëria e institucionit e ka të pamundur të bëjë buxhetim specifik për planin strategjik, për më tepër, institucioni nuk ishte në gjendje të tregojë se çfarë është procesi i harmonizimit të planit strategjik me buxhetin vjetor dhe atë afatgjatë. Ekspertët kanë konstatuar se, edhe pse buxheti vjetor për vitin akademik 2018-2019 përmban linjat e gjëra buxhetore për qëllimet strategjike

kryesore, nuk është e qartë se çfarë të dhëna janë marr për bazë për ndarjen e këtyre linjave, kur merret parasysh fakti se plani strategjik nuk përmban aktivitete specifike dhe rezultate të matshme. Pos kësaj, plani strategjik nuk përmban afate kohore, masa, caqe dhe tregues të performancës (numra dhe përqindje për secilën objektivë), prandaj ekipi i ekspertëve nuk e ka të qartë si Kolegji bën vlerësimin e progresit, pra nëse është duke ecur në rrugën e duhur, me çfarë shpejtësie si dhe nëse është arritur një objektiv i caktuar. Një prej organeve kryesore të Kolegjit është Bordi i Kolegjit. Sipas Statutit anëtarët e Bordit emërohen nga Bordi i Aksionarëve, mirëpo kriteret specifike të emërimit të anëtarëve të bordit të kolegjit nuk janë të publikuara në mënyrë transparente në *Rregulloren për organizimin e aktiviteteve të Bordit të Kolegjit* e as në Statutin e Kolegjit. Sipas Statutit një anëtar i Bordit duhet të jetë një student i caktuar nga parlamenti studentor, megjithatë bazuar në përbërjen e Bordit që i është dërguar ekspertëve në kuadër të dokumenteve shtesë asnjë student nuk ishte përfshirë në listën e anëtarëve të Bordit. Ani pse sipas statutit, Rektori është si menaxher kryesor i Kolegjit ka përgjegjësi për funksionimin e rregullt dhe efektiv të Kolegjit dhe ka autoritet për kryerjen e këtyre detyrave, përshtypja e ekspertëve ishte se “de facto” Presidenti i Kolegjit është menaxheri i Kolegjit. Ekspertët kanë potencuar se përveç rolit dhe përgjegjësi formale, rektori nuk është përgjegjës në asnjë prej pyetjeve të shtrura nga ekipi i ekspertëve që ishin në kuadër të fushëveprimit të Rektorit. Ekspertët po ashtu kanë gjetur se sipas *Rregullores për organizimin e punës së Senatit*, senati ka për detyrë të përzgjedhë anëtarët e Bordit të Kolegjit, mirëpo sipas Statutit, të gjithë anëtarët e Bordit emërohen nga Aksionarët. Sa i përket Këshillit të Dekanëve, ekipi i ekspertëve konstaton se një pjesë e përgjegjësi të kësaj trupe janë të mbivendosura me rolin e Senatit. Nga sa u tha më lartë, ekipi i ekspertëve konstaton se kriteret dhe proceset e përzgjedhjes së vendimmarrësve dhe pozitave tjera nuk janë të qarta, transparente dhe të publikuara në rregulloret e institucionit, gjë që nuk krijon kushte për menaxhim efektiv dhe efikas të aktiviteteve të institucionit. Ekipi i ekspertëve gjithashtu mendon se mungesa e transparencës në këtë aspekt krijon hapësirë për gjykim subjektiv dhe standarde të dyfishta në propozimin/emërimin/përzgjedhjen e kandidatëve. Gjatë vizitës ekspertët vërejtën se menaxhmenti dhe stafi administrativ ishin jokonsistent sa i përket ndarjes së detyrave dhe përgjegjësi në fushën e financave, sigurimit të cilësisë dhe menaxhimit të burimeve njerëzore.

Sa i përket kapitullit të standardeve “Integriteti akademik, përgjegjësia dhe llogaridhënia publike”, ekspertët kanë gjetur se Kolegji ka zhvilluar një Kod të Etikës i cili përfshinë fusha të ndryshme të shkeljeve të mundshme etike, mirëpo ky kod nuk vë theksin në vlera të tilla si liria akademike, autonomia institucionale, integriteti akademik dhe shmangja nga plagjiarizmi. Për më tepër nuk është e qartë për panelin e ekspertëve pse Kodi i Etikës nuk është i aplikueshëm edhe për studentët. Kolegji ka të zhvilluar *Rregulloren mbi procedurat dhe masat disiplinore* e cila përcakton procedurat disiplinore për stafin dhe studentët. Rregullorja përcakton masat disiplinore mirëpo nuk definon parimin për shqiptimin e atyre masave dhe nuk përshkruan se cila masë shqiptohet për cilën shkelje. Gjatë vizitës ekspertët kanë gjetur se stafi dhe studentët kanë njohuri për rregulloret që kanë të bëjnë me etikën dhe masat disiplinore. Ekipi i ekspertëve ka potencuar se Kolegji nuk publikon rregulloret e brendshme të tij, procedurat, raportet e vetvlerësimit dhe vendimet e organeve udhëheqëse në uebfaqen e institucionit. Gjithashtu ekspertët nuk kanë arritur të gjejnë në uebfaqen e kolegjit informata për stafin akademik, numrin e studentëve të regjistruar, procedurat e mësimdhënies, të nxënies dhe vlerësimit, nivelin e kalueshmërisë, informata për punësimin e të diplomuarve, mundësi për bursa si dhe informata mbi pagesat administrative dhe të shkolllimit. Sa i përket menaxhimit të cilësisë, ekspertët ndërkombëtar të akreditimit kanë vlerësuar se ky

kapitull i standardeve nuk përmbushet nga Kolegji Iliria. Megjithëse në Statut thuhet se sigurimi i cilësisë mbulon të gjitha fushat e aktiviteteve të Kolegjit, ekspertët kanë gjetur se aty përshkruhet vetëm pyetësi me studentë për cilësinë e mësimdhënies si mekanizëm për sigurimin e cilësisë. Ekspertët kanë gjetur se sipas rregullores *Politikat e kolegjit për avancimin e punës akademike dhe sigurimit të cilësisë* flet për themelimin e Komisionit për Sigurim të Cilësisë. Sipas kësaj rregulloreje kryesuesi i këtij komisioni duhet të jetë ekspert i jashtëm i emëruar nga Bordi i Kolegjit. Megjithatë kjo rregullore nuk përmend se kush duhet të jenë anëtarët tjerë të komisionit. Sipas raportit të vetvlerësimit, njësia qendrore e cila koordinon aktivitetet lidhur me sigurimin e cilësisë në kolegji është Zyra për Promovim të Cilësisë, megjithatë funksioni, përgjegjësitë dhe raportimi i kësaj zyreje nuk është i definuar as në Statut, as në politikat e kolegjit për avancim të cilësisë e as në standardet dhe udhëzuesit për promovim të cilësisë. Përkitazi me këtë kapitull të standardeve ekipi i ekspertëve ka listuar në raportin e vlerësimit të jashtëm një varg mospërputhjesh dhe kontradiktash midis rregulloreve dhe politikave të ndryshme të kolegjit. Në lidhje me kapitullin e standardeve të manualit të akreditimit i cili i është dedikuar mësimdhënies dhe të nxënit, ekspertët kanë theksuar se sipas Statutit, përmbajtja e kurrikulave përcaktohet me anë të rregulloreve të përgatitura nga Këshilli Akademik i fakulteteve përkatëse, mirëpo gjatë vizitës së ekipit të ekspertëve në kolegji këto rregullore nuk janë përmendur asnjëherë si referencë. Statuti nuk ofron informata lidhur me procesin e zhvillimit të kurrikulave e as sa i përket përfshirjes së palëve të interesit në këtë proces. Ekspertët po ashtu kanë gjetur se kolegji nuk ka procedura për monitorimin e efektivitetit të politikave dhe procedurave të zhvillimit dhe zbatimit të programeve. Nga takimet që ka zhvilluar ekipi i ekspertëve në kolegji është konfirmuar se nuk ekziston një proces formal i angazhimit të përfaqësuesve të të diplomuarve apo punëdhënësve në zhvillimin e programeve apo në ndryshimin e atyre ekzistuese.

Sa i përket hulumtimit, ekspertët kanë vërejtur se institucioni ka përcaktuar atë si një prej qëllimeve kryesore strategjike në planin strategjik 2018-2022. Megjithatë është konstatuar se objektivat strategjike për hulumtim janë shumë të përgjithshme dhe ekspertët nuk kanë arritur të identifikojnë fushat specifike në të cilat institucioni do t'i fokusojë aktivitetet hulumtuese. Megjithëse buxheti i institucionit tregon një linjë buxhetore për hulumtim dhe aktivitete shkencore, gjatë vizitës ekipi i ekspertëve gjati se stafi mësimdhënës nuk kanë njohuri për procedurat se si të kërkojnë mjete financiare për hulumtim nga institucioni, dhe pjesa më e madhe e stafit nuk kanë përfutur fonde nga institucioni për të përkrahur aktivitetet e tyre kërkimore apo pjesëmarrjen në konferenca. Sa i përket kapitullit të standardeve "Stafi, proceset e punësimit dhe zhvillimi profesional", ekspertët kanë konstatuar se kolegji nuk përmbushë ato. Ekipi i ekspertëve ka gjetur se, sa i përket kësaj fushe, ka kundërtënie në mes të procedurave të përshkruara në rregulloren *"Award of scientific titles, teaching titles, professional teaching titles and associate title"* dhe tekstit të Statutit. Për shembull, sipas Statutit komisioni i dorëzon tek rektori kandidatët e përzgjedhur për emërim si staf akademik, kurse sipas rregullores së përmendur më lartë komiteti i dërgon kandidatët e përzgjedhur tek dekani e pastaj ata emërohen me shumicë votash nga Senati. Sa i përket kërkesave për angazhim të stafit administrativ, Statuti jep një përshkrim shumë të përgjithshëm për rekrutimin e menaxhmentit të lartë, ndërsa nuk ka fare përshkrim të procesit të rekrutimit për stafin administrativ. Përveç kësaj ekspertët kanë gjetur se institucioni nuk ka të zhvilluar një sistem për vlerësim të performancës së stafit administrativ.

Sa i përket administratës së studentëve dhe shërbimeve mbështetëse, ekspertët kanë vënë në pah faktin se megjithëse në raportin e vetëvlerësimit institucioni potencon se merr parasysh nivelin socio-ekonomik

të studentëve dhe suksesin e tyre akademik dhe përkitazi me këtë ofron mundësi për ulje të tarifave të studimit, procedurat dhe kriteret për të përfituar nga këto mundësi nuk janë bërë publike. Ekipi i ekspertëve shpreh shqetësim sa i përket nivelit të braktisjes, e cila ka një mesatare prej 26% në vit, gjë që nënkupton se gjysma e studentëve të regjistruar nuk diplomojnë. Arsyet për këtë nuk janë elaboruar në raportin e vlerësimit, kurse gjatë vizitës së ekspertëve si arsye kryesore është përmendur niveli i ulët i cilësisë në shkollimin e mesëm. Përveç kësaj ekipi i ekspertëve ka gjetur se stafi mësimdhënës dhe studentët nuk kanë njohuri për procedura zyrtare ankimore për studentët, pasi që çështje të tilla zakonisht zgjidhen në mënyrë joformale. Ky element nuk është përmendur në asnjë prej dokumenteve të vëna në dispozicion nga Kolegji.

Duke u bazuar në gjetjen e ekspertëve si dhe në rekomandimin final të tyre për mos akreditimin e Kolegjit Iliria, KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Sa i përket programeve të studimit të cekura në dispozitiv të këtij vendimi, ekspertët ndërkombëtarë kanë konstatuar se programet e studimit të cekura më sipër përmbushin substancialisht kapitujt e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit dhe rrjedhimisht kanë rekomanduar dhënien e riakreditimit. Megjithatë, duke pasur parasysh Nenin 15, paragrafin 6, të Ligjit për Arsimin e Lartë Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011, i cili përcakton se *"Nëse një bartës i licencuar i arsimit të lartë nuk arrin të fitojë akreditimin apo riakreditimin institucional, kjo do të rezultojë me një organizim tjetër të akreditimit jo më vonë se pas një viti"* dhe paragrafin 7 i cili përcakton se *"Nëse dështon për herë të dytë në marrjen e akreditimit, atëherë i hiqet licenca. Kundër heqjes së licencës, bartësi mund të ankohet në organin kompetent konform Ligjit për Procedurën Administrative dhe Ligjit të Konfliktit Administrativ"*, Kolegjit Iliria i ndalohet regjistrimi i studentëve të rinj në programet e studimit me akreditim valid për vitin akademik 2019 – 2020 deri në periudhën e riakreditimit të dytë institucional, sipas dispozitave të cekura më sipër. Studentët e regjistruar në programet e studimit para marrjes së vendimit për mos riakreditim institucional, vazhdojnë studimet e tyre në përputhje me statutin e institucionit si dhe me dispozitat e tjera në fuqi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesë sipas Nenit 125 dhe 126 të Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L-031, datë 25 Maj 2016). Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit të Komisionit të Ankesave të AKA-së, sipas Rregullores nr. 2/2019, në afatin prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas Nenit 127 të LPPA.

Vendimi iu dërgohet:

- Kolegjit Iliria
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.



Prof. Dr. Gazmend Luboteni

Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë